

# Bolonja për këmbësorë<sup>1</sup>

## Ç' është Procesi i Bolonjës?

Procesi i Bolonjës është një proces evropian reformimi që synon krijimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë deri në vitin 2010. Ky është një proces i pazakonshëm, me strukturë fleksibile që udhëhiqet nga 46 vende anëtare që marrin pjesë në këtë bashkëpunim, me një numër të konsiderueshëm të organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe Këshillin e Evropës.

Kjo që u tha më sipër, me siguri, nuk paraqet përgjigje të plotë në pyetjen e bërë. Prandaj, përgjigja është dhënë në vijim:

Deri në vitin 2010 sistemet e arsimit të lartë në Evropë duhet të organizohen në qatë mënyrë që::

- të mund të lëvizet lehtë nga një vend në vendin tjetër (brenda Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë) me qëllim të vazhdimit të studimeve, apo të punësimit;
- të shtohet atraktiviteti i arsimit të lartë në Evropë, ashtu që shumë njerëz nga vendet evropiane të vijnë për studime në Evropë;
- Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë i siguron Evropës një bazë të gjerë, cilësore dhe të avancuar të Dijes dhe siguron zhvillimin e Evropës si komunitet stabil, paqeruajtës dhe tolerant.

Ky synim është mjaft ambicioz dhe nuk lidhet vetëm me Procesin e Bolonjës. Megjithatë, në kuadër të Procesit zhvillohen parakushtet e nevojshme për realizimin e synimeve të tilla.

Para se të vazhdojmë më tutje, duhet sqaruar dy gjëra:

Procesi i Bolonjës nuk bazohet në marrëveshje ndërqeveritare.

Ministrat kompetentë për arsim të lartë të vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës kanë adoptuar disa dokumente, por këto dokumente nuk janë juridikisht obliguese (për dallim nga marrëveshjet ndërkombëtare që, zakonisht, janë obliguese). Pra, është vullneti i lirë i secilit vend dhe i komunitetit të tij të arsimit të lartë, t'i pranojë apo t'i refuzojë parimet e Procesit të Bolonjës, megjithëse efekti i "presionit ndërkombëtar nga vendet tjera" nuk duhet nënvlerësuar.

Nuk parashihet që deri në vitin 2010 të gjitha vendet evropiane duhet të kenë sisteme të njëjta të arsimit të lartë.

Përkundrazi, një ndër vlerat evropiane është baraspesha në mes të diversitetit dhe unitetit. Në vend të unitetit, Procesi i Bolonjës tenton të vendosë ura që lehtësojnë lëvizjen e individëve nga një vend në vendin tjetër. Prandaj, edhe nëse, p.sh. sistemet e thirrjeve bëhen më të ngjashme me njëri-tjetrin, duhet të ruhet natyra specifike e secilit nga sistemet e arsimit të lartë. Nëse jo, cili do të ishte qëllimi i studimit në ndonjë vend tjetër, nëse ajo që studiohet është e njëjtë si në shtëpi? Zhvillimet brenda Procesit të Bolonjës duhet të lehtësojnë "përkthimin" e një sistemi në sistemin tjetër, pra duhet t'i kontribuojnë lëvizshmërisë së studentëve dhe personelit akademik, si dhe ta shtojnë punësueshmërinë anekënd Evropës.

---

<sup>1</sup> Ky dokument është material promovues i Këshilli të Evropës publikuar në ueb faqen [http://www.coe.int/t/dg4/highereducation/EHEA2010/BolognaPedestrians\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg4/highereducation/EHEA2010/BolognaPedestrians_en.asp)

## Si organizohet Procesi

Ka disa nivele të implementimit të Procesit të Bolonjës – ndërkombëtar, kombëtar dhe institucional.

Kur bëhet fjalë për nivelin ndërkombëtar – janë disa mundësi bashkëpunimi dhe disa struktura që zhvillojnë Procesin e Bolonjës. Ekziston, i ashtuquajti, Grup Përcjellës i Bolonjës (BFUG) që përbëhet nga vendet nënshkruese dhe Komisioni Evropian, si dhe nga Këshilli i Evropës, Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA), Unioni Evropian i Studentëve (ESU, ish-ESIB), Asociacioni Evropian i Institucioneve të Arsimit të Lartë (EURASHE), UNESCO-CEPES, Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), Struktura Pan-Evropiane e Education International dhe Bashkimi i Konfederatave të Industrisë dhe të Punëdhënësve të Evropës (UNICE) si anëtarë konsultativë.

Përveç kësaj, seminare të shumta organizohen anekënd Evropës dhe mbajnë etiketën jozyrtare “seminaret e Bolonjës”. Këto seminare debatojnë për çështje të ndryshme të Procesit të Bolonjës, pengesat në implementim dhe bashkëpunimin e mundshëm. Kalendari i këtyre evenimenteve publikohet në ueb faqen e Sekretariatit të Bolonjës, të cilën e mban kryesuesi i radhës.

Çdo dy vjet organizohet një konferencë ministrore ku ministrat përgjegjës për arsimin e lartë të vendeve nënshkruese mbledhen për të vlerësuar progresin, si dhe për të dhënë udhëzime dhe përcaktuar prioritetet për periudhën vijuese. Konferenca e fundit është mbajtur në Londër në maj të vitit 2007. Konferencat e mëhershme janë mbajtur në Berlin (2003), Pragë (2001) dhe në Bolonjë (1999) – shih në vijim për më shumë informacion.

Niveli kombëtar zakonisht përfshinë qeverinë dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë, konferencat e rektorëve ose asociacionet tjera universitare, unionet e studentëve, por, në disa raste, edhe agjencitë për sigurimin e cilësisë, punëdhënësit, etj. Shumë vende evropiane kanë ndryshuar legjislacionin në përputhje me Procesin e Bolonjës, ndërsa disa vende të tjera janë duke u përgatitur për këtë. Varësisht nga vendi dhe nga zhvillimi i arsimit të lartë në të, disa vende janë duke e zbatuar Sistemin Evropian për Transferin e Krediteve (ECTS), janë duke shqyrtuar sistemin e thirrjeve dhe të kualifikimeve, të financimit dhe të menaxhimit të arsimit të lartë, programet e mobilitetit, etj.

Niveli institucional përfshin institucionet e arsimit të lartë, fakultetet dhe departamentet e tyre, përfaqësuesit e personelit dhe të studentëve dhe shumë aktorë të tjerë. Prioritetet ndryshojnë nga një vend në tjetrin dhe nga një institucion në një tjetër. Sidoqoftë, është me rëndësi të theksohet se, pa një implementim adekuat në nivel institucional, shumë pak mund të arrihet në arritjen e objektivave të Bolonjës.

## Si filloi Procesi?

Procesi filloi zyrtarisht në vitin 1999 me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës. Njëzetënëntë shtete nënshkruan Deklaratën më 19 qershor 1999 në Bolonjë (prandaj edhe Procesi quhet Procesi i Bolonjës). Deklarata përmban këto objektiva:

- adoptimi i një sistemi lehtësisht të kuptueshëm dhe të krahasueshëm të thirrjeve;
- adoptimi i një sistemi të bazuar në dy cikle, ciklin paradiplomik dhe pasdiplomik;

- vendosja e sistemit të krediteve – siç është ECTS;
- nxitja e mobilitetit duke tejkaluar pengesat për lëvizje të lirë të studentëve, mësimdhënësve, hulumtuesve dhe personelit administrativ;
- nxitja e bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë;
- nxitja e dimensionit të nevojshëm evropian në arsimin e lartë.

Këto gjashtë objektiva janë thelbi i Procesit të Bolonjës dhe, që atëherë, janë zhvilluar më tutje – shih më poshtë.

Sidoqoftë, para se të nënshkruhej Deklarata e Bolonjës, katër vende – Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar - kanë adoptuar një dokument tjetër – Deklaratën e Sorbonës. Kjo deklaratë ka dhënë një shtytje të fuqishme drejt Deklaratës së Bolonjës dhe, që në vitin 1998, ka përcaktuar synimet kryesore të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

## 1999

### Ç' ndodhi pas vitit 1999?

Pas nënshkrimit të Deklaratës së Bolonjës u organizua struktura përcjellëse. U formua Grupi Përcjellës i Bolonjës i përmendur më lartë. Ky grup vendosi që takimet ministrore të mbahen çdo dy vjet dhe takimi i parë u mbajt në Pragë në vitin 2001. Në ndërkohë, u emërua raportuesi i përgjithshëm i Grupit Përcjellës. Ishte ky z. Pedro Lourtie, i cili më vonë u bë zëvendësministër i arsimit në Portugali. Detyra e tij ishte të monitorojë implementimin e objektivave të Deklaratës së Bolonjës dhe t'u raportojë për këtë ministrave të arsimit në Pragë. Për më tepër, shumë vende organizuan, të ashtuquajtura, "seminare të Bolonjës" që mbuluan fusha të ndryshme me interes. Asociacioni i Universiteteve Evropiane (që u themelua në marsin e vitit 2001 nga dy rrjete universitare evropiane) hartoi të ashtuquajturin "Raporti për Trendet II" – raporti për implementimin e Deklaratës së Bolonjës në nivel të institucioneve dhe adoptoi Porosinë nga Konventa e Salamankës 2001. ESIB adoptoi Deklaratën Studentore të Geteborgut si porosi e studentëve për Samitin Ministror të Pragës.

\*

## Pragë 2001

Në majin e vitin 2001 në Pragë vende të reja ju bashkuan Procesit të Bolonjës: Kroacia, Qipro, Lihtenshtajni dhe Turqia. Ministrat adoptuan, të ashtuquajturën, Komunikatën e Pragës që përcakton udhëzimet për dy vitet e ardhshme deri në Konferencën Ministrore të Berlinit në vitin 2003.

Është me rëndësi të theksohet se Samiti i Pragës përcaktoi disa elemente të reja në Proces:

- studentët njihen si partnerë të plotë dhe të barabartë në procesin e vendimmarrjes, ndërsa ESIB u bë anëtar konsultativ i Grupit Përcjellës të Bolonjës (bashkë me Këshillin e Evropës, Asociacionin e Universiteteve Evropiane dhe EURASHE),
- dimensionin social i Procesit të Bolonjës fiton rëndësi të veçantë,
- fuqizohet ideja për arsimin e lartë si pasuri dhe përgjegjësi publike,

Prej vitit 2001 deri në vitin 2003 u organizua një numër edhe më i madh i "seminareve të Bolonjës". Z. Pavel Zgaga (ish-ministër i arsimit të Sllovenisë dhe njëri ndër nënshkruesit e Deklaratës së Bolonjës) u emërua raportues i përgjithshëm; EUA publikoi "raportin për Trendet III", si dhe filloi Projektin për Kulturën e Vlerësimit në institucionet e arsimit të lartë, e, po ashtu, filloi programin e përbashkët master; ESIB bëri disa hulumtime në mesin e studentëve për implementimin e Deklaratës së Bolonjës; Komisioni Evropian u dha përkrahje disa projekteve evropiane (Projekti Tunning, Projekti TEEP) që lidhen me sigurimin e cilësisë.

\*

### Berlin 2003

Në Konferencën Ministrore të Berlinit mbajtur në shtator të vitit 2003, në Procesin e Bolonjës u pranuan shtatë anëtare të reja (Shqipëria, Andorra, Bosnja dhe Hercegovina, Selia e Shenjtë, Serbia dhe Mali i Zi dhe „ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“). Kështu, numri i përgjithshëm i shteteve anëtare u rrit në 40. Gjithashtu, u mar vendim që vendet nënshkruese të Konventës Kulturore Evropiane mund të marrin pjesë në Procesin e Bolonjës, nëse aplikojnë për anëtarësi dhe prezantojnë një plan të kënaqshëm për implementimin e synimeve të Bolonjës në sistemet e tyre të arsimit të lartë. Përveç analizës së zhvillimeve në periudhën 2001-2003 dhe përcaktimit të udhëzimeve për punë të mëtutjeshme, Komunikata e Berlinit, po ashtu, dha këto përfundime:

- Kërkimi shkencor është një aspekt i rëndësishëm i arsimit të lartë në Evropë, si dhe se Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë dhe Hapësira Kërkimore Evropiane janë dy shtylla të shoqërisë së bazuar në dije. Për më tepër, është e domosdoshme që Procesi i Bolonjës të shkojë përtej fokusimit në dy cikle, duke përfshirë në vete edhe ciklin e tretë – studimet e doktoratës.
- Deri në takimin e radhës të vitit 2005, ministrat do të mbledhin informacion për progresin në tri fusha kyçe:
  - sigurimi i cilësisë;
  - sistemi i dy cikleve;
  - njohja e diplomave dhe e periudhave të studimit;
- Konferenca Ministrore e radhës do të mbahet në Bergen në vitin 2005.

Nga Grupi Përcjellës i Bolonjës u kërkua të analizojë, në veçanti, dy çështje:

- Sigurimi i cilësisë – mandati për këtë iu besua ENQA, EUA, ESIB dhe EURASHE;
- Korniza e kualifikimeve.

\*

### Bergen 2005

Në Konferencën Ministrore të Bergenit në majin e vitit 2005, Procesit iu shtuan edhe 5 vende të tjera (Armenia, Azerbajxhani, Gjeorgjia, Moldova dhe Ukraina), duke e rritur numrin e vendeve pjesëmarrëse në 45. U vendos, po ashtu, të zgjerohet rrethi i anëtarëve konsultativë me Rrjetin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e

Lartë (ENQA), Struktura Pan-Evropiane e Education International dhe Bashkimin e Konfederatave të Industrisë dhe të Punëdhënësve të Evropës (UNICE). Takimi i Bergenit konfirmoi lëvizjen nga planet për të ardhmen drejt implementimit praktik. Thekset më të rëndësishme ishin:

- Adoptimi i një kornize gjithëpërfshirëse të kualifikimeve për Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë me obligim që kornizat kombëtare të kualifikimeve të elaborohen deri në vitin 2010, ndërsa puna për hartimin e tyre të fillojë më së voni në vitin 2007;
- Adoptimi i udhëzimeve dhe standardeve për sigurimin e cilësisë dhe kërkesa nga ENQA, EUA, ERUASHE dhe ESIB për elaborim të propozimeve lidhur me regjistrin e agjencive për sigurimin e cilësisë;
- Nënvizimi i serishëm i rëndësisë së dimensionit social të arsimit të lartë që nënkupton – por nuk kufizohet në – mobilitetin akademik;
- Nevoja për përmirësimin e ndërveprimit në mes të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe pjesës tjetër të botës („dimensioni i jashtëm“);
- Rëndësia e shtuar e marrjes me zhvillime në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë pas vitit 2010.

\*

### **Këshilli i Evropës**

Kur bëhet fjalë për rolin e Këshillit të Evropës në ndërtimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë deri në vitin 2010, përqendrimi vazhdon të jetë në:

- Angazhimin e Këshillit në njohjen e kualifikimeve, duke përkrahur rrjetin ENIC (bashkë me UNESCO-CEPES) dhe vendet anëtare në implementimin e Konventës së Lisbonës;
- Pjesëmarrja aktive në mekanizmat drejtues dhe politikëbërës (Grupi Përcjellës i Bolonjës), si dhe në seminarët zyrtarë të Bolonjës (si folës ose si raportues);
- Këshillë dhe asistencë vendeve që, kohëve të fundit, kanë marrë vendim të aderojnë në Procesin e Bolonjës, në baza bilaterale ose rajonale;
- Çështjet gjithëpërfshirëse siç është përgjegjësia publike për arsimin e lartë dhe kërkimin, qeverisja në arsimin e lartë, dimensionin social i arsimit të lartë dhe kërkimit, si dhe vlerat dhe roli i arsimit të lartë dhe kërkimit në shoqëritë bashkëkohore dhe komplekse;

### **Kush merr pjesë në Proces?**

Pas Konferencës Ministrore të Bergenit, janë 45 vende pjesëmarrëse në Procesin e Bolonjës:

prej vitit 1999: Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Latvia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar;

prej vitit 2001: Kroacia, Qipro, Lihnteshtajni, Turqia;

prej vitit 2003: Shqipëria, Andorra, Bosnja dhe Hercegovina, Selia e Shenjtë, Rusia, Serbia, "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë";

prej vitit 2005: Armenia, Azerbajxhani, Gjeorgjia, Moldova dhe Ukraina;

prej vitit 2007: Mali i Zi.

Përveç shteteve (që janë të gjitha anëtare të Grupit Përcjellës të Bolonjës - BFUG), marrin pjesë edhe disa organizata ndërkombëtare:

Komisioni Evropian

Këshilli i Evropës – anëtar konsultativ

Asociacioni i Universiteteve Evropiane – anëtar konsultativ

EURASHE – anëtar konsultativ

ESU – Unioni i Studentëve Evropianë (më parë ESIB) – anëtar konsultativ



UNESCO-CEPES – anëtar konsultativ

ENQA – anëtar konsultativ

Struktura Pan-Evropiane e Education International – anëtar konsultativ

UNICE – anëtar konsultativ

**Kjo broshurë u përkthye si pjesë e projektit “Promovimi i Procesit të Bolonjës në Kosovë” që implementohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) në partenritet me Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Lubjanës (Slloveni) dhe me Universitetin e Peloponezit (Greqi).**



Education and Culture

## Tempus

Ky projekt është financuar nga Komisioni Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e plotë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe, në asnjë rrethanë, nuk duhet t'i atribuohet Komisionit.